

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Fejzullah Rexhepi kryetar, Zenel Leku dhe Frosina Sylejmani anëtarë, në çështjen juridike të paditësit A.H., nga fshati ..., K. e Pejës, i përfaqësuar nga e autorizuar L.L., nga Peja, kundër të paditurit E.L., nga fshati ... K. Pejës, të cilin e përfaqëson avokat Z.M., nga Peja, në çështjen për kompensim të dëmit, duke vendosur lidhur me ankesën e të autorizuarit të paditurit dhe ankesën e të autorizuarit të palës paditëse, të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë, C.nr.822/12 të datës 14.11.2013, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 16.02.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHEN si të pa themelta ankesa e të autorizuarit të paditurit E.L., nga fshati ... K. Pejës dhe ankesa e të autorizuarit të palës paditëse A.H., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë, C.nr.822/12 i datës 14.11.2013, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar, C.nr.822/12, të datës 14.11.2013, në dispozitiv të saj, ka detyruar të paditurin E.L., nga fshati ... K. e Pejës, që paditësit A.H. nga fshati ... K. e Pejës, që në emër të kompensimit të dëmit për shkak të prerjes dhe marrjes në mënyrë të paautorizuar dhe të kundërligjshme të lëndëve teknike të breut në sasi prej 36 m³, në vendin e quajtur "...", nën ngastra kadastrale nr.72/9, pronë e H.H., babait këtu të paditësit sipas fletës poseduese Nr.51 ZK- ..., gjatë verës së vitit 2000, t'i paguajë shumën prej 3240 euro, në afat prej 15 ditësh, nga dita e dorëzimit të aktgjykimit me kamatë ligjore si për mjete të cilat i paguajnë bankat afariste për destinimet përtej një viti, që nga dita e nxjerrjes së aktgjykimit e deri në pagesën definitive e nën kërcënim të përmbarimit me dhunë. Detyrohet i padituri E.L. që paditësit A.H., të ia paguajë shpenzimet e procedurës në shumë prej 2755 euro, e në afat prej 15 ditësh, nga dita e dorëzimit të aktgjykimit nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë i autorizuari i të paditurit, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit jo të plotë të gjendjes së fakteve dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e

Apelit në Prishtinë, këtë ankesë ta aprovojë si të bazuar, aktgjykimin e kundërshtuar ta prishë sërish dhe çështjen t'ia kthejë Gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankesë edhe i autorizuari i palës paditëse, për shkak të vërtetimit të gabuar të dispozitave të së drejtës materiale, lidhur me llogaritjen e kamatës- në borxhin kryesor, me propozim që Gjykata e Apelit në Prishtinë, aktgjykimin e atakuar si nën pikën I, të dispozitivit- sa i përket borxhit kryesor në shumë prej 3.240 euro, të Ndryshohet dhe se ashtu që Gjykata e shkallës së dytë, ta detyroi të paditurin që paditësit t'i paguajë borxhin kryesor në shumë prej 3.240 euro, me kamatë ligjore si për mjetet të cilat i paguajnë bankat afariste për klientët e vetë për destinimet përtej një viti, duke e llogaritur nga data e padisë 25.09.2001 e deri me datë 31.12.2012, ndërsa nga data 01.01.2013, e deri në pagesën definitive i padituri të detyrohet që paditësit t'ia paguajë kamatën ligjore, vjetore, në lartësi prej 8 %, (n. 382 par.2 i LMD-së), plus kamatën vjetore në borxhin kryesor në lartësi prej 12%, (n. 384 i LMD-së, e drejta e shpërblimit të plotë), deri në pagesën definitive.

Përgjigje në ankesën e të paditurit ka paraqitur paditësi, duke e kundërshtuar atë dhe njëkohësisht ka paraqitur kërkesë për kompensimin shtesë për ankesën e palës paditëse, për përgjigje në ankesën e palës së paditur, për taksa gjyqësore, për ankesë, për padi dhe për vendimin e Gjykatës në lëndën C.nr.822/12.

Gjykata e Apelit i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 194 të LPK-së dhe gjeti se:

-Ankesat janë të pa themelta

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi ka ushtruar padi ndaj të paditurit, me datë 25.09.2001, me kërkesë për kompensim dëmi material. Gjykata Komunale në Pejë, me aktvendimin C.nr.638/01 të datës 26.09.2006, kishte pushuar procedurën lidhur me këtë çështje. Më datë 28.12.2006, paditësi kishte paraqitur kërkesë duke propozuar që të caktohet shqyrtimi gjyqësor. Gjykata Komunale në Pejë, me aktgjykimin e saj C.nr. 638/01 të datës 09.06.2011, kishte aprovuar kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar. Kundër këtij vendimi kishte paraqitur ankesë i autorizuari i paditësit, duke e kundërshtuar vendimin e shkallës së parë. Ankesë kishte paraqitur edhe i autorizuari i palës së paditur, duke e kundërshtuar vendimin e lartcekur. Përgjigje në ankesën e të paditurit ka paraqitur i autorizuari i paditësit, me propozim që ankesa e të paditurit të refuzohet dhe ankesa e palës paditëse të aprovohet. Gjykata e Qarkut në Pejë, me aktvendimin Ac.nr. 352/2011, të datës 08.10.2012, ka prishur aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Pejë C.nr.638/01 të datës 09.06.2011, dhe çështja i është kthyer të njëjtës Gjykatë në rishqyrtim dhe rivendosje. Me datë 18.09.2013, i autorizuari i palës paditëse kishte paraqitur parashtesë me të cilën kishte bërë rregullimin dhe precizimin e petitumit të kërkesëpadisë.

Gjykata e shkallës së parë, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit kryesor, vendosi sikurse në dispozitiv të saj, duke e detyruar të paditurin që ta kompensojë paditësin për dëmin material,

vendimin e saj e mori konform neneve 154 par.1, të LMD-së, nenit 277 të LMD-së, ndërsa sa i përket shpenzimeve të procedurës, vendimin e bazoi konform nenit 452 par.1 të LPK-së.

Gjykata e Apelit e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm sa i përket vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, për arsye se aktgjykimi nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe nuk ka shkelje nga neni 182 par.2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, nuk ka aplikim të gabuar të drejtës materiale për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Gjykata e shkallës së parë në tërësi e ka vërtetuar gjendjen faktike e cila nuk vihet në dyshim me pretendimet ankimore dhe kështu e kishte një pasqyrë reale mbi gjendjen në këtë çështje juridike, për këto arsye aktgjykimi i shkallës së parë është vërtetuar.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, duke e obliguar të paditurin që ta kompensojë paditësin si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, ka vendosur në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme, në bazë të provave që ka pasur në shkresat e lëndës, ka bërë vlerësimin e Ekspertizës së ekspertit D.L., në lëmin e pylltarisë, i cili kishte konstatuar se nuk mund të caktohet saktësisht numri i cungjeve, të trungjeve të prera në vitin 2000, dhe se ekspertiza për këtë dëm është e vonuar dhe se çdo konstatim mund të jetë përafërsisht i konstatuar dhe vlerësuar dhe kurrësi i saktë, si dhe ekspertiza e ekspertit- gjeodet Q.M., e datës 29.04.2013, i cili kishte bërë identifikimin e ngastrës kadastrale ku ishte shkaktuar dem paditësit. Me datë 16.09.2013, eksperti sipas kërkesës së Gjykatës, kishte dërguar Raportin, ku kishte bërë hulumtimin e tregut në lidhje me çmimin e mesatar për lënde (trupa), të breut dhe hormoqit, dhe se çmimi mesatar për trupa për sharritje të kualitetit të mirë është 90.00 €/m³, dhe se sipas konstatimeve të tij, vlera e masës drunore trupa teknik të breut të dëmit të konstatuar në sasi prej 36 m³, është 3.240 €. Po ashtu, Gjykata kishte vërtetuar se i padituri për këtë dëmtim ishte dënuar për vepër penale vjedhje pylli, me aktgjykim penal të formës së prerë, P.nr. 303/2000, datë 2202.2001, nga Gjykata Komunale në Pejë, pasi ishte gjetur fajtor për sasinë prej 40 metra kub lisa breu, prej të cilave sasia prej 36 metra kub ishte vjedhur në pronën e paditësit, për kompensimin e dëmit si i dëmtuar paditësi është udhëzuar në kontest civil.

Andaj në rastin konkret ekziston detyrimi i të paditurit për kompensimin e dëmit paditësit, bazuar edhe në dispozitën e nenit 154 par.1, dhe 158 të LMD-së¹, ndërsa lartësinë e dëmit në rastin konkret është vërtetuar në mënyrë të përafërt përmes ekspertizës duke u bazuar edhe në sasinë e dëmit të përcaktuar përmes aktgjykimit penal të formës së prerë, P.nr. 303/2000, datë 2202.2001 të Gjykatës Komunale në Pejë, në sasinë prej 36 metra kub lisa breu, të cilat nëse llogariten me çmimin mesatar prej 90euro për një metër kub na jep shumë të vendosur si në aktgjykimin e atakuar, andaj gjykata vlerëson se llogaritja si në ekspertizë është e drejtë, bazuar edhe në dispozitën e nenit 323 të LPK-së, ku përcaktohet “Nëse vërtetohet se palës i takon e

¹ LMD-së-ligji për marrëdhëniet e detyrimeve publikuar në GZ të RSFJ-së nr.29, dt.26.05.1978,

drejta që t'i shpërblehet dëmi me të holla apo me sende të zëvendësueshme, por pa mundësi që të caktohet shuma e të hollave, apo sasia e sendeve të tilla, apo se një gjë e tillë do të mund të bëhej me vështirësi shumë të mëdha, gjykata për këtë do të vendos sipas çmuarjes së lirë.” Andaj edhe në rastin konkret vendosja sipas aktgjykimit të atakuar është e drejt.

Gjykata e Apelit pretendimet ankimore sipas ankesës të ushtruar nga i autorizuari i të paditurit i konsideron si të pa bazuara, pretendimi ankimor se aktgjykimi është konfuz, sepse i njëjti nuk mund të kuptohet, ky pretendim për Gjykatën e Apelit është i pa bazuar, për faktin se gjykata e shkallës së parë sa i përket dëmit material ka vendosur sipas kërkesëpadisë të paditësit, për 36 m³, në vlerë prej 3.240 €, duke u bazuar në ekspertizat e punuara nga ekspertët e lartcekur për dëmin e shkaktuar nga i padituri.

Pretendimi ankimor i palës paditëse në ankesë se gabimisht është zbatuar e drejta në kamatë, më të cilën ka kërkuar që të ndryshohet aktgjykimi i atakuar, dhe të caktoi lartësinë prej 8%, Gjykata ka zbatuar nenin 277 të LMD-së, të vitit 1978, i cili ka qenë në fuqi kur edhe është shkaktuar ky dëm, dhe në momentin kur është kërkuar kompensimi i dëmit, pasi ligji i ri ka hyre në fuqi në vitin 2012, dhe se Gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë ka vendosur për kamatën, prandaj vlen kamata ligjore si për mjetet të cilat i paguajnë bankat për destinimet përtej një viti, nga nxjerrja e aktgjykimit e deri në pagesën definitive, sikurse në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Gjykata e Apelit vlerëson se sa i përket shpenzimeve të procedurës me të cilat i padituri është obliguar që t'i kompensoj paditësit në shumën prej 2755 euro, është vendosur në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme, pasi nga shkresat e lëndës rezulton se kemi katër seanca të shtyra në shumë prej 60 euro, katër parashtresa nga 121 euro, përpilimi i ankesës në procedurën e mëparshme në shumë prej 242 euro, taksë për padi në shumë prej 51 euro, taksat gjyqësore për ankesë në shumë prej 31 euro, taksë për aktgjykim të shkallë së parë dhe të dytë, në shumë prej 52 euro, shpërblimi për dy ekspert në shumë prej 72 euro, dhe shqimi dhe kopjimi i shkresave të lëndës penale P.nr.303/2000, në shumë prej 85 euro, që e përbëjnë shumën e gjykuar si në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar, por pasi nuk kemi pretendim ankimor nga pala e paditur në këtë drejtim, aktgjykimi sa i përket shpenzimeve mbetet i pa ndryshuar dhe gjykata nuk do të arsyetoj aktgjykimin në këtë aspekt.

Nga të cekurat u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi në bazë të nenit 195.1 pika d), e lidhur me nenin 200 të LPK-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.4137/2013, më datë 16.02.2018

Kryetari i kolegjit-gjyqtari
Fejzullah Rexhepi